



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

PROJEKT –VENDIM

NR____, DATË__/__/2025

**PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË
DURRËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E TIJ.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”, Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit. Akteve Ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e amenduar dhe Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik botuar nga OSCE (2008), shkresës së Prefektit Durrës nr.638 prot., datë 29.09.2025, protokolluar me tonën nr. 11671 prot., datë 30.09.2025 si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e krijimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Durrës dhe rregulloren për organizimin dhe funksionimin e tij.
2. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.174, datë 01.12.2023 “Për krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Durrës dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij”.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.


DREJTORIA LIGJORE

**Drejtore
Alneida Rroshi**



KRYETAR I BASHKISË

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI JURIDIK**

RELACION

**PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË
DURRËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E TIJ**

Të nderuar këshilltarë,

Referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit, Akteve Ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e amenduar dhe Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik botuar nga OSCE (2008), Këshilli Bashkiak Durrës vendosi me Vendimin nr. 174, datë 01.12.2023, ngritjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Durrës.

Ndryshimet ligjore të Ligjit nr. 36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, në nenin 12/1 përcakton se ngritja e këshillave vendorë të sigurisë publike propozohet nga Prefekti, i cili me shkresën nr.638 prot., datë 29.09.2025, protokolluar me tonën nr. 11671 prot., datë 30.09.2025 inicion nisjen e procedurave administrative nga ana jonë si dhe zbatimin e VKM-së nr. 678, datë 30.10.2024. Gjithashtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”, detajon në mënyrë më të hollësishme përbërjen e këshillit vendor, përgjegjësitë e kryetarit të këshillit vendor, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, detyrat e Sekretariatit Teknik, mënyrën e organizimit dhe koordinimit të mbledhjeve, rendit të ditës, hartimit të procesverbaleve të mbledhjes, vendimmarrjen, publikimin etj. Duke qenë se në pikën 18, të VKM- së nr. 678, datë 30.10.2024 parashikohet që këshillat vendorë të sigurisë publike dhe Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet ngrihen brenda 3 muajve nga botimi i këtij akti në Fletoren Zyrtare, si dhe për arsye se ndryshimet ligjore bien ndesh me rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, të miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës me Vendimin nr.174, datë 01.12.2023, kërkohet nga ana juaj shfuqizimi i këtij vendimi.

Ju kujtojmë që bazuar në nenin 29, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, parashikohet që bashkia është përgjegjëse për garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet, parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor.

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike funksionon si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues për problematikat që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurinë në komunitet. Këshilli përbëhet nga përfaqësues të institucioneve publike, por në mbledhjet e tij mund të ftohen përfaqësues nga institucionet gjyqësore, përfaqësues të komuniteteve fetare, organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve etj..., nga ku kërkohet përgjegjësi qytetare, përgjegjësi institucionale për adresimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre sipas tagrit që secili institucion ka. Synimi kryesor i Këshillit është të vërë në lëvizje të gjithë aktorët vendorë për të trajtuar së bashku çështjet që lidhen me kriminalitetin, dhunën në familje dhe ekstremizimin e dhunshëm. Po ashtu, ky grupim këshillimor, që kryesohet nga kryetari i bashkisë do të shërbejë për të identifikuar sfidat e komunitetit vendor sa i takon sigurisë personale. Gjithashtu një qëllim i rëndësishëm është edhe vendosja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm mes gjithë aktorëve vendorë, përfshirë shoqërinë civile, policinë, shërbimet sociale etj. Duke qenë se neni 54, gërma "k" e Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përcakton se organizimi dhe funksionimi i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike realizohet nëpërmjet një rregulloreje, e cila miratohet nga Këshilli Bashkiak si dhe nisur nga propozimi i Prefektit të Qarkut Durrës bazuar në nenin 12/1 të Ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" për ngritjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike. Ju relatojmë për rregulloren përkatëse të organizimit dhe funksionimit të tij, më poshtë :

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE NË BASHKINË DURRËS

NENI 1 OBJEKTI

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i përbërjes, detyrave, përgjegjësisë si dhe mënyra e funksionimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike pranë Bashkisë Durrës.

NENI 2 BAZA LIGJORE

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.
- Ligji nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar.
- Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" i ndryshuar.
- Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.
- Ligji nr. 103/2014 "Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë".
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024 "Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet".

- VKM nr.930, datë 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit”.
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

NENI 3 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) pranë bashkisë. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP) funksion si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues pranë bashkisë mbi problematikat që lidhen me sigurinë e komunitetit për çështje të rendit dhe sigurisë publike. KVSP nuk ushtron veprimtari me interes ekonomik dhe për këtë arsye nuk ka buxhet të veçantë. Qëllimi i KVSP-së është të kontribuojë në rritjen e sigurisë publike si një organ këshillimor në Bashki nëpërmjet:

- Identifikimin e problemeve në lidhje me sigurinë dhe rendin publik;
- Rritjes së ndjenjës së sigurisë;
- Nxitjes së angazhimit të komunitetit në çështjet e sigurisë publike;
- Identifikimit të pikave të nxehta përsa i përket situatës kriminale, aksidenteve në qarkullimin rrugor, sjelljeve anti-shoqërore dhe kundërvajtjeve dhe marrjen e masave për zbutjen e këtyre rreziqeve;
- Hartimi i rekomandimeve dhe aktiviteteve për rritjen e sigurisë dhe rendit publik drejtuar autoriteteve përgjegjëse për identifikimin e çështjeve që paraqesin rrezik për sigurinë dhe rendin publik;
- Diskutimi i raporteve dhe të dhënave lidhur me sigurinë në bashki dhe identifikimin e masave për adresimin e problemeve;
- Hartimi dhe /ose dhënia e rekomandimeve mbi Planet e Veprimit për Sigurinë Publike;
- Komunikimi dhe informimi i vazhdueshëm i institucioneve përgjegjëse për sigurinë publike dhe sociale mbi problematikat e identifikuara dhe elementët e tjerë të lidhur me sigurinë publike, etj.

NENI 4 PËRBËRJA

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike përbëhet si më poshtë:

- Kryetar i Bashkisë Durrës;
- Shefi i Komisarariatit të Policisë;
- Drejtuesi i Policisë Bashkiake;
- Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;
- Drejtuesi i emergjencave civile në bashki;
- Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- Përfaqësuesi i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor;
- Përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
- Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- Përfaqësuesi i administratës rajonale të zonave të mbrojtura;

- Koordinatori vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- Përfaqësuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijëve;
- Kryeinspektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit;
- Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit..
- Përfaqësues nga Prefekti i Qarkut Durrës.
- Përfaqësues nga Komisariati i Policisë Durrës.
- Përfaqësues nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
- Përfaqësues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
- Përfaqësues i Policisë së Qarkut.
- Përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës.
- Përfaqësues nga Drejtoria e Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.
- Përfaqësues nga komuniteti i biznesit.
- Përfaqësues nga secili komunitet fetar.
- Përfaqësues nga OJF-të.
- Përfaqësues nga Media.

Në varësi të temave të rendit të ditës, Kryetari i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike mund të ftojë në mbledhjet e tij përfaqësues nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm, komunitetet fetare, organizatat e shoqërisë civile (organizatat rinore, të grave, të bizneseve, të pakicave kombëtare, të universiteteve, të mediave lokale), të komunitetit, sipas rastit, Këshilli Vendor i Rinisë, shoqatat e njësive të vetëqeverisjes vendore, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.

NENI 5 PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) angazhohet për parandalimin, minimizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në çështjet që çënojnë sigurinë në komunitet;
- b) mbikëqyr dhe zbaton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
- c) identifikon, analizon dhe vlerëson problematikat lidhur me sigurinë në komunitet dhe i trajton ato në mbledhjet e këshillit;
- ç) propozon zgjidhje për problematikat e rasteve konkrete tek autoritetet kompetente shtetërore, pesëmarrëse ose jo në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
- d) identifikon prioritetet në fushën e sigurisë në komunitet dhe rekomandon përfshirjen e tyre në mbledhjen e radhës;
- dh) propozon dhe vlerëson detajet e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për sigurinë publike në komunitet dhe ia komunikon ato drejtuesve të tyre;
- e) kontribuon dhe siguron pjesëmarrje në aktivitete ndërgjegjëse për komunitetin edhe përmes projekteve për çështjet e sigurisë në komunitet;

- ë) vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij;
- f) merr në shqyrtim përmbushjen e rekomandimeve për çështjet e trajtuara në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
- g) përcakton përbërjen e sekretariatit Teknik.

NENI 6 SEKRETARIATI TEKNIK

Sekretariati teknik ushtron këto detyra:

- a) përgjigjet për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së këshillit vendor nga ana logjistike dhe administrative;
- b) mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të këshillit;
- c) organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;
- ç) njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;
- d) përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;
- dh) merr pjesë në mbledhjet e këshillit, duke mbajtur minutat e takimit;
- e) shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes midis anëtarëve;
- ë) harton procesverbalet e mbledhjes dhe raportet;
- f) mban listën e pjesëmarrësve të pranishëm në mbledhje;
- g) protokollon dhe mban arkivin e procesverbaleve të mbledhjeve;
- gj) kontrollon adresën elektronike, si mjet të komunikimit elektronik të këshillit;
- h) përgatit dhe bën publikimin e njoftimeve apo materialeve të ndryshme për publikun.

NENI 7 MBLEDHJET E KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike zhvillon mbledhjet, në bazë të rendit të ditës, të miratuar nga kryetari dhe anëtarët, sipas procedurës së mëposhtme:

- a) njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, me shkresë zyrtare ose në formë elektronike, për të cilën anëtarët kanë rënë dakord;
- b) anëtarët njoftohen paraprakisht edhe për rendin e ditës dhe për çdo informacion tjetër të nevojshëm;
- c) në përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës mund të kontribuojnë edhe anëtarët;
- ç) propozime për rendin e ditës mund të dërgohen edhe përmes adresës elektronike nga çdo qytetar;
- d) mbledhjet mbahen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të përhershëm të këshillit. Në rastet kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tri) ditë pune;
- dh) në mbledhjet me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish mund të diskutohen çështje, por nuk mund të merren vendime pa kuorumin e nevojshëm;
- e) mbledhja hapet dhe drejtohet nga kryetari, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës, si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së këshillit;
- ë) kryetari drejton diskutimin, përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës;
- f) anëtarët diskutojnë në bazë të rendit të ditës dhe raportojnë për detyrat;
- g) në mbledhje shqyrtohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara, sipas rendit të ditës, por anëtarët kanë të drejtën e propozimit për të diskutuar edhe çështje të tjera;

- gj) në përfundim të mbledhjes, mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari;
- h) në procesverbal mbahet shënim lista e pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë, të cilët duhet të njoftojnë me shkrim arsyet e mospjesëmarrjes;
- i) Këshilli vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij;
- j) pas çdo mbledhjeje, publiku informohet përmes një njoftimi në faqen zyrtare të bashkisë për datën e mbledhjes, pjesëmarrjen, çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës dhe përmbledhjen e diskutimeve;
- k) publikimi i njoftimit bëhet brenda 3 (tri) ditëve pune nga zhvillimi i mbledhjes.

NENI 8 VENDIMMARRJA

Këshilli vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij. Në rastet kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tri) ditë pune. Vendimet e marra në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike dërgohen pranë prefektit të qarkut, brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e tyre. Prefekti i qarkut, pas çdo vendimi të marrë nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, informon Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet.

NENI 9 DISPOZITA KALIMTARE

Ndryshimet dhe plotësimet në këtë rregullore do të bëhen sa herë të ketë ndryshime në legjislacionin në fushën e sigurisë publike.
Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Bashkiak Durrës.

Duke ju falenderuar, jemi të sigurtë në bashkëpunimin Tuaj për miratimin e Rregullores së re të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Durrës.
Rregullorja e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.174, datë 01.12.2023 "Për krijimin e këshillit vendor të sigurisë publike në bashkinë durrës dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij", shfuqizohet.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore
Almeida Rroshi

